



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim  
Agencija Kosova za Akreditaciju  
Kosovo Accreditation Agency



Data: 08.06.2016

Ref.: 411/16

Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), neni 7, dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.02/2013, datë 16.01.2013), nenin 126 dhe 136 të Ligjit mbi Procedurën Administrative, nr. 02/L-28, datë 22.07.2005, Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 42-të, të mbajtur më 31 maj 2016, mori:

## V E N D I M

- I. REFUZOHET kërkesa për rishqyrtim të vendimit nr. 543/16, datë: 19.05.2016 e BPrAL Shkolla e Lartë Profesionale “QEAP Heimerer”, si e pa bazë.
- II. Mbetet në fuqi vendimi i KSHC-së nr.235/16, datë 22.04.2016.

## Arsy etimi

BPrAL SHLP “QEAP – Heimerer” ka parashtuar kërkesë (nr.543/16, datë: 19.05.2016) për rishqyrtim të vendimit të Këshillit Shtetëror të Cilësisë (KSHC) nr.235/16, datë 22.04.2016. Përmes kësaj kërkesë, “QEAP – Heimerer” ka kërkuar që të hiqet kufizimin sipas pikës II të vendimit të KSHC-së për regjistrim të studentëve në programin e studimit Infermieri /BSc.

KSHC ka shqyrtuar kërkesën e SHLP QEAP Heimerer dhe ka vendosur të refuzojë kërkesën për rishqyrtim të datës 22.04.2016 dhe të lë në fuqi vendimin e KSHC-së të marrë më datë 22.04.2016.

KSHC ka analizuar kërkesën për rishqyrtim të vendimit të dorëzuar nga BPrAL SHLP “QEAP Heimerer” në lidhje me kufizimin e numrit të studentëve të cilët do të regjistrohen në programin e studimit Infermieri/ BSc. KSHC ka konstatuar se ky institucion nuk ka sjell dëshmi të reja dhe relevante të cilat do të mund të merren parasysh për të ndryshuar vendimin e KSHC-së. KSHC konsideron se për momentin gjendja faktike në “QEAP Heimerer” nuk ka ndryshuar nga gjendja e prezantuar në aplikacionin për ri/akreditim si dhe gjatë vizitës në terren me ekspertët ndërkombëtarë të akreditimit. “QEAP Heimerer” vazhdon të ketë kapacitete të limituara për të pranuar më tepër studentë, se sa numrin e rekomanduar nga ekspertët ndërkombëtarë të akreditimit në raportin final të vlerësimit.

KSHC konsideron se vetëm në momentin kur gjendja faktike e “QEAP Heimerer” të ndryshojë, institucioni mund të i nënshtrohet procesit të ri/vlerësimit dhe kufizimi i numrit të studentëve të ri/vlerësohet në përputhje me kapacitetet të cilat institucioni i posedon.

**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të paraqes padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative. Afati për paraqitjen e padisë është 30 ditë nga momenti i pranimit të këtij vendimi përfundimtar.

Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Vendimi iu dërgohet:

- BPrAL SHLP “QEAP – Heimerer”
- MASHT;
- Arkivit të AKA-së.

---

Prof. Asoc. Dr. Blerim Rexha  
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë